Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 962/20
Date/Datum. 30.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Gjemajli Bellanica; G. Bellanica.	20.11.2020	30.11.2020	962/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.11.2020 OE **"PUNA" SH.P.K -Prizren,** ka parashtruar ankesë me nr: 962/20 kundër njoftimit për dhënie të kontratës,lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Ndërtimi i objektit të qendrës së mjekësisë familjare në fshatin Krushevë –Projekt dy vjeçar**" , me nr. të prokurimit: **621-20-3171-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK DRAGASH.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Punë, vlera e parashikuar e kontratës: **212 550,00** €.

Data e njoftimit për kontratë.....30.06.2020.
Data e hapjes së ofertës.....22.07.2020.
Data e njoftimit për dhënien e kontratës.....04.08.2020.
Data e njoftimit të ofertuesve të pasuksesshëm.....04.08.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim .....17.08.2020.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....24.08.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim .....10.11.2020.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....12.11.2020.

Data e Ankesës së dytë në OSHP.....17.11.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE **"PUNA" SH.P.K - Prizren**

Dispozitat e shkelura

Neni 1 - Qëllimi;
Neni 7 - Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi;
Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës;
Neni 64 - Dështmitë e kërkesave;
Neni 69 - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
Vendimi i OSHP-së nr 595/20 i datës 13.10.2020;

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Të nderuar autoriteti kontraktues në njoftimin mbi vendimin e dt.05.11.2020 e ka rekomanduar për kontratë OE "EBK SH.P.K", ndërsa ne jemi shpallur si tenderues të eliminuar me arsyetimin se "Tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshëm, sepse në pozicionin: KALDAJA-NENSTACIONI-pozicioni 3. 1. 12 nuk është plotësuar pozicioni për qmimin njësi (mungon qmimi); Sipas udhëzuesit Operativ neni 39.8-Mungon qmimi-Refuzo tenderin pa kërkuar infurmacion të mëtejshëm".

Ne me dt.06.11.2020 kemi kërkuar qasje në dokumente të këtij aktiviteti të prokurimit mirëpo AK-ja deri me dt.10.11.2020 nuk na ka lejuar qasje në dokumentacion, prandaj ka shkelur nenin 10 të LPP-së. Ndërsa në mungesë të qasies në dokumentacion ne kemi ngritur pretendimet ankimore me aq sa kemi njohuri nga ankesa e kaluar dhe nga zhvillimi i këtij aktiviteti të prokurimit.
Ju sqarojmë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron për faktet si në vijim:

Në lidhje me pozicionin 3.1.12 ku për të cilin AK-ja ka theksuar se nuk është vendosur qmimi ju sqarojmë se në këtë pozicion nuk është parashikuar të kryhet ndonjë punë apo furnizim i veqantë por është parashikuar të vendoset qmimi i pozicionit 1.16 dhe të nxjerret 50 % i këtij qmimi i dhënë në pozicionin 1.16, prandaj nëse shumëzohet 0.5 X 112.00 €- atëherë del qmimi 56.00 €. Në këtë rast nuk është e vërtetë se ne nuk kemi dhënë në ndonjë pozicion qmim por në pozicionin 3.1.12 është dashur vetëm të përshkruhet qmimi I pozicionit 1.16 dhe të nxjerret përllogaritja e saktë e përqindjes duke e shumëzuar 0.5 X 112.00 €.
Pra ky rast mund të llogaritet një gabim aritmetikor nga ana jonë, por i cili nuk e kalon +l-2%o sç është e parashikuar në nenin 41.8 tö RRUOPP-së. Gabimi ynë është aritmetikor për faktin se ne në të gjitha pozicionet që janë kërkuar për të vendosur qmim kemi vendos qmim, mirëpo nuk është bërë përllogaritja nga ana jonë, prandaj duke u bazuar në këtë fakt në momentin e përllogaritjes së këtij pozicioni rezulton se diferenca e gabimeve aritmetikore të jetë 100 euro, e cila është vlerë minimale dhe që nuk kalon 2 përqindëshin e gabimit aritmetik.

Referimi i AK-së në nenin 39.8 të RRUOPP është plotësisht i gabueshëm dhe tendencioz sepse në këtë rast nuk kemi të bëjmë fare me mungesë të qmimit dhe nuk është e vërtetë se ne nuk kemi ofruar gmim për njësi, sepse në të gjitha pozicionet kemi dhënë qmimi për njësi por është bërë një gabim aritmetikor i pastër sepse nuk kemi përllogaritur 0.5 X 112.00 € që është qmimi i pozicionit 1.16, prandaj ky rast është plotësisht gabim aritmetikor dhe jo mos dhënie e qmimit në pozicione.

Andaj duke u bazuar në faktin e lartcekur shihet qartë se ne nuk kemi ofertuar me Qmim 00.00 €, mirëpo që ka ndodhur një gabim në përllogaritje, gabim ky i cili është tëresisht aritmetik, andaj dhe AK-ja është dashur ta përmisoj gabimin e bërë nga ana jonë dhe jo të na diskriminoj në këtë aktivitet të prokurimit duke na eliminuar edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Se AK-ja është dashur ta përmisoj gabimin e bërë nga ana jonë e parasheh qartë edhe neni 41.8 i RRUOPP-së pika i ku është e cekur shumë qartë "41.8 AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetikë në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës.
i. Ne rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësoj gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B49. Në rast se OE në fjalë nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta në fjalë do të refuzohet. AK gjithashtu duhet ti dërgojë të giithë tenderuesve përkatës (OE te cilët kanë dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.", mirëpo që AK-ja nuk i ka shfrytëzuar fare këto dispozita duke u munduar të na eliminoj nga ky aktivitet me arsye të cilat nuk qëndrojnë, pasi që është shumë e qartë se gabimi ynë është tërësisht aritmetik dhe nuk është dashur të eliminohemi nga ky aktivitet i prokurimit.
OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së përkatësisht kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 9.1&9.2, ku kërkesë ka qenë "Minimumi i mesatares së fuqisë punëtore dhe stafit menaxherial për secilën naq tri vitet e fundit", ndërsa si dëshmi është kërkuar "Deklaratë apo raport për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udheheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e shkuara".
OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë sepse nuk e ka ofruar deklaratën e lartcekur andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm dhe jo tö rekomandohet për kontratë.
Ne vendimin e panelit shqyrtues te OSHP-se nr.595/20 te dt.13.10.2020, ne lidhje me pretendimin tone te lartcekur, paneli shqyrtues ka konstatuar se AK-ja duhet te vertetoj se a plotesohet kjo kerkese e vendosur ne njoftimin per kontrate dhe tek dosja e tenderit sipas nenit 9.1&9.2 , nga ana e OE te rekomanduar per kontrate. Mirepo edhe pse OSHP-ja e ka detyruar AK te vertetoj se a plotesohet kjo kerkese nga ana e OE te rekomanduar per kontrate, AK-ja nuk e ka respektuar fare vendimin e lartcekur pasi qe, nuk e ka vertetuar fare se a plotesohet kjo kerkese apo jo. Mirepo vet fakti se neve nuk na eshte lejuar qasja ne dokumentacionin e OE te rekomanduar per kontrate,tregon qarte dhe gjithashtu e verteton edhe me shume pretendimin tone ankimor se OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka plotesuar perseri kete kerkese, andaj edhe eshte dashur te shpallet i papergjegjshem, pasi qe nese OE i rekomanduar per kontrate do ta plotesonte kerkesen e lartcekur, atehere do te na lejohej edhe qasja ne dokumentacionin e OE te rekomanduar per kontrate.

Gjithashtu OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem edhe per faktin se nuk e ka plotesuar kerkesen e FDT-se tek kapaciteti teknik dhe profesional ne lidhje me inxhinierin e makinerise ku kerkese ka qene *"Inxhinier i diplomuar i Makinerise - (5 vjear ose master)"*, ndersa si deshmi eshte kerkuar *"Kopjet e diplomave perkatese, CV-te e nenshkruara nga vete inxhinieret, kontratat valide me Operatorin Ekonomik, ose marreveshje bashkepunimi (parakontrat) me kete projekt e nenshkruar nga te dyja palët. Deklarata mbi menaxherin* ". OE i rekomanduar per kontrate nuk e ploteson kerkesen e lartpermendur sepse nuk e ka ofruar fare diplomen per inxhinierin e kerkuar, mirepo e ka ofruar vetem certifikaten e cila nuk verteton qe inxhinieri i makinerise i ofruar nga OE i rekomanduar per kontrate ka diplomuar. Mirepo kjo certifikate eshte e pavlefshme pasi qe si deshmi eshte kerkuar kopja e diplomes dhe jo certifikata.

Po ashtu edhe ne lidhje me kete pretendim tonin paneli shqyrtues i OSHP-se ne vendimin nr.595/20 te dt.13.10.2020, ka kerkuar nga AK-ja qe ta vertetoj se a e ploteson kerkesen e lartcekur OE i rekomanduar per kontrate, mirepo qe nuk eshte respektuar fare nga ana e AK-se ky vendim i OSHP-se pasi qe AK-ja nuk e ka bëre kurrfare vertetimi qe tregon se OE i rekomanduar per kontrate e ploteson kerkesen e lartcekur, andaj pasi qe AK-ja nuk ka vertetuar se OE i rekomanduar per kontrate e ploteson kete kerkese dhe gjithashtu nga mos lejimi i qasjes ne dokumentacionin e OE te rekomanduar per kontrate po vertetohet edhe me shume se pretendimi yne eshte i bazuar, pasi qe siç e cekem më lartë, nese OE i rekomanduar per kontrate do ta plotesonte kerkesen e lartcekur atehere do te vertetohej edhe nga ana e AK-se dhe gjithashtu do te na lejohej qasja ne dokumente.

Pra edhe ne kete rast AK-ja nuk e ka respektuar vendimin e lartcekur te panelit shqyrtues te OSHP-se, pasi qe nuk ka vertetuar me asnje deshmi se OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem , ndersa vendimi i panelit ka qene shume i qarte, te vertetohet se a i ka permbushur apo jo kerkesat sa i perket pretendimeve tona ankimore OE i rekomanduar per kontrate, mirepo AK-ja edhe pse nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-se perseri po vazhdon me avazin e njejte duke e rekomanduar per kontrate perseri te njejtin OE edhe pse nuk ka ofruar asnje deshmi se OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem.

OE i rekomanduar per kontrate nuk ka vazhduar sigurimin e tenderit me kohe, prandaj ky OE eshte i papergjegjshem sepse sigurimi i tenderit te ketij operatori ekonomik ka shkeputje, andaj edhe eshte dashur te shpallet i papergjegjshem, sepse shkeputjet siç e dijme nuk jane te lejuara perderisa kerkohet te vazhdohet sigurimi i tenderit, atehere vazhdimi i tij duhet te behet para datës së skadimit te sigurimit, mirepo jo te behet dy-tri dite pas dates se skadimit.

Gjithashtu OE i rekomanduar per kontrate ka bere gabim ne perllogaritje sepse tek pozicioni 3.1.12, nuk e ka vendosur qimin e pozicionit 1.16 siç eshte e kerkuar e qe eshte dashur ta vendos qimin 160.00 €, por ka vendos nje q mim tjeter 117.50 € qe ne nuk e dijme ku e ka marr dhe ka bere shumezimin 0.5 X 235.00 €, ne menyre te gabueshme dhe jo si eshte kerkuar ne paramase.

Andaj duke u baazuar ne faktet e lartcekura pasi qe nuk na eshte lejuar qasja ne dokumentet e OE te rekomanduar per kontrate me kete rast nuk eshte respektuar neni 10.3 i LPP-se dhe ne nuk kemi munduar te analizojme dokumentacionin eventual shtese te OE te rekomanduar per kontrate, andaj OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem ne lidhje me te gjitha kerkesat e lartcekura dhe duhet te shpallet i papergjegjshem

Ne pajtohemi me arsyet e eliminimit qe AK-ja i ka dhene ne letrat standarde per tenderuesit e eliminuar per OE "DAR ING" SH.P.K & "ENGRUP", "ASTRAPLAN" SH.P.K & "U-Unique" SH.P.K, "Top Projekt" & Niki-GD, "AAG Projekt" SH.P.K & NNSH "REAL, "RIDVAN ELEZI" B.I (ALFA- ING), "LIMITPROJECT" SH.P.K.

Ne me dt. 12.11.2020 kemi marre pergjigje ne kerkesen per rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kerkesa per rishqyrtim, mirepo nuk ka dhene asnje pergjigje konkrete dhe ligjore per refuzimin e kerkeses tone per rishqyrtim.
Ne lidhje me arsyen e pare te AK-se per refuzimin e kerkeses tone per rishqyrtim, AK-ja nuk e ka shqyrtuar fare pretendimin tone ankimor pasi qe ne vendimin per refuzim te kerkeses per rishqyrtim, ka vendosur te njejtin arsyetim sikurse ne njoftimin mhi vendimin, ku e ka cekur se duke u bazuar ne nenin 39.8 te RRUOPP-se refuzohet kerkesa juaj per rishqyrtim. Mirepo ju sqarojme se ky arsyetim i AK-se eshte i pa bazuar, per faktin se nuk eshte dhene asnje arsye konkrete qe tregon se pretendimi yne ankimor eshte analizuar nga ana e AK-se. Pasi qe ne e kemi sqaruar shume qarte se referimi i AK-se ne nenin 39.8 te RRUOPP eshte plotesisht i gabueshem dhe tendencioz sepse ne kete rast nuk kemi te bejme fare me mungese te qmimit dhe nuk eshte e vertete se ne nuk kemi ofruar qmim per njesi, sepse ne te gjitha pozicionet kemi dhene qmimin per njesi por eshte bere nje gabim aritmetikor i paster sepse nuk kemi perllogaritur 0.5 X 112.00 € qe eshte qmimi i pozicionit 1.16, prandaj ky rast eshte plotesisht gabim aritmetikor dhe jo mos dhenie e qmimit ne pozicione.

Andaj duke u bazuar ne kete fakt shihet qarte se ne nuk kemi ofertuar me qmim 00.00 €,
mirëpo që ka ndodhur nje gabim ne perllogaritje, gabim ky i cili eshte teresisht aritmetik, andaj dhe AK-ja eshte dashur ta permisoj gabimin e bere nga ana jone. Faktin se AK-ja eshte dashur ta përmisoj gabimin e bër nga ana jone e parasheh qarte edhe neni 41.8 i RRUOPP-se pika i. Andaj shihet qarte se ky arsyetim i AK-se eshte tërësisht i pa bazuar dhe nuk qendron.

Ne lidhje me arsyetimin e AK-së për mos lejimin e qasjes ne dokumente, ju sqarojme se vete AK-ja e ka vertetuar se nuk na eshte ofruar qasja ne dokumente, kinse eshte nderprere sistemi dhe materiali ka mbetur ne versionin e draftit. Mirepo nese AK-ja do te kishte vullnet per te na ofruar qasje ne dokumente, atehere ka mundur qe edhe pas kerkeses per rishqyrtim te na ofroje qasje, mirepo qe nje veprim te tille nuk e ka bere, qe tregon qarte se ky arsyetim i AK-se eshte vetem nje pretekst per te na eliminuar neve nga ky aktivitet i prokurimit.

Andaj duke u bazuar ne faktet e lartcekura shihet qarte se arsyetimi i AK-se eshte i pa bazuar dhe nuk qendron.

Duke u bazuar ne te gjitha deshmite dhe faktet qe u ceken me larte konstatojme se ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve nuk eshte bere ne harmoni me nenin 59 te LPP-se, sepse eshte rekomanduar per kontrate OE i cili nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate.

Gjithashtu nuk eshte respektuar edhe kriteri kryesor per dhenie te kontrates e qe ka qene tenderi i pergjegjshem me qmimin me te ulet sic parashihet edhe ne nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se, sepse eshte rekomanduar per kontrate operatori ekonomik i papergjegjshem.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 te LPP-se, sepse e ka favorizuar operatorin ekonomik te rekomanduar per kontrate duke e rekomanduar per kontrate edhe pse nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e FDT-se dhe te njoftimit per kontrate, ndersa neve na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e FTD-se dhe te njoftimit per kontrate dhe njekohesisht jemi OE me cmim me te lire. Paragrafi I i nenit 7 te LPP-se e parasheh qarte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne menyre te barabarte dhe jo- diskriminuese dhe do te veproje ne menyre transparente.

Gjithashtu autoriteti kontraktues eshte dashur te kete ne konsiderate edhe nenin 1 te LPP- se, pasi qe dihet se qellimi i ketij ligji eshte te siguroje menyren me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytezimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove.

Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhe deshmite qe u ceken me larte, kerkojme nga OSHP qe te merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e OE "Puna Shpk" si e bazuar, dhe lenda kthehet ne
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-se per dhenie te kontrates dhe Jenda kthehet ne
RIVLERESIM,
DETYROHET autoriteti kontraktues qe gjate rivleresimit, ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kerkesat e dosjes se tenderit, njoftimit per kontrate dhe konform dispozitave te LPP-se.

Nese nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojme proceduren ligjore ne institucionet tjera kompetente.

KRITERETPËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

1. Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin përkatës profesional, të bizneseve dhe ose të korporatave.
2. Regjistrimi i numrit fiskal për kompanitë vendore.
3. Certifikata e TVSH-së.
4. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenc -ISO 9001 2015- Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë Vërejtje Certifikatat e natyrës se njëjtë ISO më të avancuara pranohen.

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

1.Operatorët Ekonomik duhet të kenë një qarkullim financiar së paku 425000,00 € në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1. Kontrata të përfunduara jo më pak se (318000,00 €) të lëmisë së kërkuar (Ndërtim të objekteve) në periudhën e shkuar tre vjeçare
2. a)Menaxheri i projektit - Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë -Drejtimi konstruktiv (5 vjeçar,ose master) b)Inxhinier i diplomuar i Hidroteknikës - (5 vjeçar,ose master), c)Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës - (5 vjeçar ose master) d)Inxhinier i diplomuar i Makinerisë - (5 vjeçar ose master)

3. Minimumi i mesatares së fuqisë punëtore dhe stafit menaxherial për secilën nga tri vitet e fundit.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

1. Certifikata e regjistrimit të biznesit-Kopje

2. Certifikata e numrit fiskal-Kopje

3. Certifikata e TVSH-së-Kopje

4. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatat ISO valide (kopje)

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

1. Raportin,raportet nga një ose më shumë banka të përcjellura me pasqyra financiare ose deklaratat vjetore ne ATK me të cilat dëshmohet se O.E ka pasur një qarkullim financiar në tri vitet e fundit sipas kërkesës së lartshënuar.

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1. Kontrata, listën e kontratave të lëmisë së kërkuar(Ndërtim të objekteve) ,duke bashkangjitur referencat ose procesverbalet e pranimit përfundimtare te punëve me sukses të realizuara, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve në ne tri vitet fundit, valide që janë deri me datën e njoftimit për kontratë. Në rast konzorciumi lideri duhet të ofroj së paku 60 % të projekteve te kërkuara (Ndërtim i objekteve) te përfunduara ne tri vitet e fundit (procesverbalet e pranimit teknik ose referencat)

2. Kopjet e diplomave përkatëse, CV-te e nënshkruara nga vetë inxhinierët,kontratat valide me Operatorin Ekonimik,ose marrëveshje bashkëpunimi(parakontrat) me këtë projekt e nënshkruar nga të dyja palët. Deklarata mbi menaxherin e projektit

3. Dekleratë apo raport për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e shkuara

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
***Kuvendi Komunal-Dragash* shpërblen** me kontratë:

1.	**EBK SH.P.K., 811290874**	**177 537,33**

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "PUNA" SH.P.K -Prizren

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues pretendon se AK nuk i ka lejuar qasje në dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe OE ankues thtë se pretendimet ankimore i kemi ngritur me njohurit që kishim nga ankesa e kaluar dhe nga zhvillimi i këtij aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues vlerson që nuk është respektuar paragrafi 3 dhe 5 i LPP-së.Në bazë te LPP-së Autoriteti Kontraktues është i obliguar që t'u ofroj qasje në dokumentacion për aktivitetin e prokurimit.

Paragrafi 3 i LPP-së thotë:

Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.

Paragrafi 5 i LPP-së thotë:

Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

Autoriteti Kontraktues e ka eleminuar OE ankues me arsyetimin se KALDAJA-NENSTACIONI - pozicioni 3.1.12 nuk është plotësuar çmimi për njësi.OE ankues pretendon qe ka qen gabim aritmetikor që nuk kalon +/-2% dhe nuk është dashur të eleminohet për këtë gabim.

Pas analizës së dokumentacionit të ofruar në E prokurim,eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues në

paramasën e ofruar tek pozicioni 3.1.12 nuk e ka përshkruar çmimin në rubrik.Shih në vijim tabelen me të dhënat.

3.1	KALLDAJA- NËNSTACIONI				
3.1.1	Kaldaja për ngrohje qendrore me ujë të ngrohtë 90/70oC me lëndë djegëse Pelet komplet me broner transportues rezervuar ditorë dhe automatikë Kapacitet nominal Q=200 Kw	cope	1	4,900.00 €	4,900.00 €
3.1.2	Akumulatorë i nxehtesisë me Vellim V=500 l komplet me izolimin adekuat për ruajtjen e energjisë termike	cope	1	350.00 €	350.00 €
3.1.3	Konstruksioni mbajtës i kaldajave	cope	1	30.00 €	30.00 €
3.1.4	Qynga e Kaldajes komplet me kthesa deri në oxhak për kaldajat 200 kW	cope	1	20.00 €	20.00 €
3.1.5	Ventil sigurues me sustë , p=3 bar , DN 25	cope	2	30.00 €	60.00 €
3.1.6	Pompa Riqarkulluese Tip:Wilo TOP S 50/7	cope	2	100.00 €	200.00 €
3.1.7	Pompa Riqarkulluese Tip:Wilo RS 25/7	cope	1	60.00 €	60.00 €
3.1.8	Ena expanduese V=110 L , me temperatura punuese -10°C 110°C,pmax – 10 bar	cope	1	70.00 €	70.00 €
3.1.9	Kolektor shpërndarës Ø 159mm x1 metra	cope	1	60.00 €	60.00 €
3.1.10	Kolektor shpërndarës Ø 159mm x1 metra	cope	1	60.00 €	60.00 €
3.1.11	Gypat të çelikut				
	DN 40	m	26	5.00 €	130.00 €
	DN 25	m	20	3.50 €	70.00 €
	DN 20	m	15	2.50 €	37.50 €
3.1.12	Fitingu nga gypat e çelikut është 50% nga Pos 1.16	%	0.5		0.00 €

Lidhur me këtë eksperti shqyrtues vlerson se OE ankues për pozicionin 1.16 ka vendosur të dhënat në paramasë ndërsa për pozicionin 3.1.12 për të cilin është eleminuar nga AK-ja se nuk ka përshkruar çmim,eksperti mendon që për këtë pozicion nuk është kërkuar kryerja e ndonjë pune e veçantë por vetëm është parashikuar të shumëzohet 50% e pozicionit 1.16 dhe të nxjerret çmimi.
Për të sqaruar sa më mirë këtë AK-ja gjatë rivlersimit mund të kërkoj sqarime nga OE ankues.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE ankues thotë se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së perkatësisht kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 9.1&9.2, nuk ka ofruar deklaratë apo raportë për fuqinë punëtore.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Minimumi i mesatares së fuqisë punëtore dhe stafit menaxherial për secilën nga tri vitet e fundit*" Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Dekleratë apo raport për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e shkuara*"

Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues sqaron se në vendimin e OSHP-së të datës 13.10.2020 me numër 595/20 thuhet: "Paneli shqyrtues Konstaton se Autoriteti Kontraktues gjate Rivleresimit duhet te vertetoje se a plotesohet kjo kerkese e vendosur ne njoftimin per kontrate dhe ne dosje te tenderit sipas neni 9.1& 9.2. nga ana e OE te rekomanduar per kontrate".

Autoriteti Kontraktues gjatë rivlersimit nuk ka përfillur vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar listën e punëtoreve aktiv të nënshkruar dhe vulosur, dhe si dëshmi ka ofruar Raportin e Administratës Tatimore të Kosovës të cilat janë të vulosura për 3 vitet e shkuara nga njoftimi për kontratë,mirëpo nuk ka ofruar Deklaratë apo raport përmesataren e fuqinë punëtore ashtu siç është kërkuar në FDT,andaj mendojmë që AK-ja duhet të respektoj vendimin e Paneli Shqyrtues dhe gjatë rivlersimit duhet të vërtetojë se a është plotësuar kjo kërkesë e vendosur në dosje të tenderit.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm për arsye se nuk e ka plotësuar kërkesën e FDT-së,tek kapaciteti teknik dhe profesional lidhur me Inxhinierin e makinerisë.

Eksperti shqyrtues konstatonë që kërkesë e Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "d) Inxhinier i diplomuar i Makinerisë - (5 vjeçar ose master)" Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Kopjet e diplomave përkatëse, CV-te e nënshkruara nga vetë inxhinierët,kontratat valide me Operatorin Ekonimik,ose marrëveshje bashkëpunimi(parakontrat) me këtë projekt e nënshkruar nga të dyja palët. Deklarata mbi menaxherin e projektit*"

Lidhur me këtë pretendim ankimor në vendimin e OSHP-së të datës 13.10.2020 me numër 595/20 thuhet: "Paneli shqyrtues Konstaton se Autoriteti Kontraktues gjate Rivleresimit duhet te vertetoje se a plotesohet kjo kerkese e vendosur ne njoftimin per kontrate dhe ne dosje te tenderit nga ana e OE te rekomanduar per kontrate".

Më datën 20.10.2020 është ngarkuar në E prokurim kopja e diplomës së inxhinierit të makinerisë, andaj pretendimi i OE ankues është i pa qëndrueshëm për faktin se është ofruar dëshmia dokumentare konformë FDT-së dhe njoftimit për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 5

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka bërë vazhdimin e sigurimit të tenderit me kohë andaj OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm sepse vazhdimi i sigurimit të tenderit duhet të bëhet para afatit të skadimit e jo pas afatit.

Me datë 16.10.2020 gjatë rivlersimit AK-ja ka kërkuar nga OE konkurues që të bëjnë vazhdimin e validitetit të sigurimit të tenderit edhe për 90 ditë.
Fillimisht OE i rekomanduar për kontratë validetin e sigurimit e ka patur në periudhë kohore nga 22.07.2020 - 20.10.2020 ndërsa vazhdimin e validitetit e ka bër prej 23.10.2020 - 21.01.2021, tre ditë pas skadimit të validitetit.

Në Nenin 31.4 të RROP thotë:

Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe ***duhet të kërkohet para datës së skadimit*** *(është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)*

Nga kjo që u tha më lartë rezulton se vazhdimi i validitetit të sigurimit nuk duhet të ketë shkëputje por të ketë vazhdimësi të validitetit,rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 6

OE ankues pretendon që i rekomanduari për kontratë ka bërë gabim në përllogaritjen e pozicioneve 3.1.12, nuk ka vendosur çmimin te pozicioni 1.16 siç është kërkuar e që është dashur ta vendos çmimin 160.00 por ka vendos një çmim tjetër 117.50 që ne nuk e dijmë nga e ka marrë dhe ka bërë shumëzim 0.5 x 235.00 në mënyrë të gabueshme e jo siç është kërkuar në paramasë.

OE i rekomanduar për kontratë në paramasën e ofruar ne platformën e E prokurimit për pozicionin 3.1.12 nuk e ka vendosur çmimin e pozicionit 1.16 siç është kërkuar dhe më pas të bëhet shumëzimi dhe të nxjerret çmimi por ka vendosur një çmim tjetër nga ai i pozicionit 1.16.
Në vijim gjeni të bashkangjitur tabelën lidhur me vendosjen e çmimit të pozicionit 3.1.12.

3.1.11	DN 40	m	26	5.00 €	130.00 €
	DN 25	m	20	3.00 €	60.00 €
	DN 20	m	15	3.00 €	45.00 €
3.1.12	Fitingu nga gypat e çelikut është 50% nga Pos.1.16	%	0.5	235.00 €	117.50 €
3.1.13	Valvul me flanxhë dhe kundër flanxhë , bulona dhe hermetizues				
	DN 40	copë	6	10.00 €	60.00 €
	DN 40	copë	3	10.00 €	30.00 €

Andaj duke pas parasysh që në këtë pozicion ka paqartësi,eksperti shqyrtues mendon që gjatë rivlersimit AK-ja të kërkojë sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 7

OE ankues thotë se: Ne pajtohemi me arsyet e eliminimit qe AK-ja i ka dhënë në letrat standarde për

tenderuesit e eliminuar për OE "DAR ING" SH.P.K & "ENGRUP", "ASTRAPLAN" SH.P.K & "U-Unique" SH.P.K, "Top Projekt" & Niki-GD, "AAG Projekt" SH.P.K & NNSH "REAL, "RIDVAN ELEZI" B.I (ALFA- ING), "LIMITPROJECT" SH.P.K.

Lidhur me pretendimin e OE ankues që pajtohet me arsyet e eleminimit nga AK-ja për OE të lartëcekur, eksperti shqyrtues vlerson se përderisa Operatorët Ekonomik të eleminuar nuk janë ankuar lidhur me eleminimin e tyre, në një mënyrë apo tjetër janë pajtuar me vendimin e AK-së.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe rekomandon që aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues	- **KK - DAGASH**
Panelit Shqyrtues	- OSHP
OE ankues	- OE **"PUNA" SH.P.K - Prizren**